

sipas mirësisë sate, me ndërmjetimet e së Tërëshenjtës Mari dhe të të gjithë Shenjtorëve.

Se Ti i bekon dhe i shenjtëron të gjitha, dhe Ty ta drejtojmë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

URATË
PËR HAPJEN E PUSIT

Le t'i lutemi Zotit.

O Zot, Perëndia ynë, që nxore ujë prej shkëmbit për popullin tënd; Ti, o Kryezot i gjithësisë, dëgjoje lutjen tonë dhe denjësona të gjejmë në këtë vend ujë të kulluar për të pirë dhe të mjaftueshëm për nevojat tona.

Se Ti je burimi i gjithë të mirave dhe Ty ta drejtojmë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

URATË
PËR ARAT, KOPSHTET APO VRESHTAT,
KUR NDODH TË DËMTOHEN PREJ ZVARRANIKËVE
APO LLOJEVE TË TJERA KEQBËRËSISH

*Pas Liturgjisë Hynore dhe bërjes së Bekimit të ujit,
lexohet urata:*

Le t'i lutemi Zotit.

O Zot, Perëndia ynë, që në fillim të krijesës sate bëre qiellin dhe dheun; dhe që nga një anë e stolise qiellin

me ndriçime të mëdha, që të ndriçojë mbi dhé, dhe nëpërmjet tyre të admirohesh Ti, Krijuesi i vetëm dhe sundimtar i krijesës; që nga ana tjetër e stolise dheun me gjelbërim dhe me bar, dhe me një larmi farash të mbjellshme sipas gjinisë, dhe që formove bukurinë e çdo luleje, dhe e bekove; Ti dhe tani, o Zot, hidh syrin nga banesa jote e shenjtë, mbi këtë pronë dhe bekoje; dhe ruaje prej çdo magjie dhe prej çdo të keqeje, dhe kureshtjeje dinake, dhe intrige njerëzish dinakë; dhe jepi asaj të ofrojë në kohë, fryte të mbushura me bekimin tënd; dhe largo prej saj çdo kafshë të egër dhe zvarranik, dhe çdo zemërim e sëmundje që vjen për të dëmtuar.

Se u shenjtërua dhe u lavdërua emri yt i gjithënderuar e madhështor, i Atit, i Birit dhe i Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Paqe në të gjithë.

Kryet tanë le t'ia ulim Zotit.

Le t'i lutemi Zotit.

O Zot Jisu Krisht, Perëndia ynë, që me ekonominë tënde mishërore e bekoje Bethlehemin dhe Gjethsemaninë, dhe më parë shtëpinë e Jakovit, i cili u quajt më pas Izrael pasi u bekua; dhe që e bekoje shtëpinë e Davidit; Ti bekoje dhe këtë pronë dhe bëje frytdhënëse në bereqet dhe me bollëk, me bekimin dhe ndërmjetimet e Zonjës sonë të pacenuar, Hyjlindëses dhe Gjithmonëvirgjërës Mari; me fuqinë e Kryqit të

nderuar dhe jetëbërës; me mbrojtjen e Fuqive qiellore, të çmuara dhe të patrup; me lutjet e të nderuarit, të lavdëruarit, Profetit, Pararendësit dhe Pagëzorit Shën Joan; të Apostujve të shenjtë, të lavdëruar dhe emërdëgjuar; të Dëshmorëve të shenjtë, të lavdëruar dhe mundës të shkëlqyer; të Dëshmorëve të shenjtë, të lavdëruar e të mëdhenj Trifon, Efstath dhe Julian; të shën (*të ditës*) dhe të gjithë shenjtorëve të tu.

Se Ti je Ai që i bekon dhe i shenjtëron të gjitha, o Krisht, Perëndia ynë, dhe Ty ta drejtojmë lavdinë, bashkë me Atin tënd pa fillim dhe me Shpirtin tënd të Tërëshenjtë, të mirë e jetëbërës, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

URATË PËR LËMIN

Le t'i lutemi Zotit.

O Zot, Perëndia ynë, që urdhërove dheun të prodhojë fruta për ushqimin tonë; Ti, o Kryezot i gjithësisë, bekoje edhe këtë lëmë dhe shumoji prodhimet e shërbëtorëve të tu; mbushi hambarët e tyre me grurë, me verë, me vaj dhe me gjithë të mirat e dheut; ruaji nën hijen e krahëve të tu; ndriçoji për të kuptuar porositë e tua dhe denjësoji për të mirat e tua qiellore. Se i bekuar dhe i lavdëruar është emri yt, i Atit, i Birit dhe i Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.